td

TEMPULLI I DIJES
NUMRI 06 / NËNTOR 2019

E tash a mi ndal fmitë prej shkolles? f.4

1 Tetori f.6

Leonidi Socialist i MAShT f.10

Astrologjia universitare f.13



editorial





ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

Templlarët:
Adea Kondirolli
Liridona Ademaj
Indrit Ferati
Zogë Hasani
Valon Dervishaj
Vesel Veseli
Dibran Hoxha
Sara Sylejmani
Lyra Hoxha
Skord Retkoceri
Gramos Buçinca
Rron Gjinovci

Dizajni:
Visar Arifaj - Kabineti

Kontakti:
www.orca-ks.org
gazeta.orca@gmail.com
+383 (45) 234 994
Rr. Simon Shiroka,
Prishtinë 10000,
Kosovë

Instagram:
Tempulli_i_dijes



Rron Gjinovci
mendimtar

ORCA është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet - KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Ky publikim është pjesë e programit të KITU-së. Ky grant është realizuar me përkrahjen e projektit Sfidimi i Korrupcionit në Arsimin e Lartë i financuar nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja është përgjegjësi e ORCA dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i KFOS-it.

kjo faqe është ende duke u punuar



Bashkë me gjethet e kësaj vjeshte, ra edhe ajo pak shpresë për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë.

Agjencia e Kosovës për Akreditim(AKA), nuk është më pjesë e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe kjo si pasojë e ndërhyrjeve apo presionit politik e biznesor, ndaj këtij institucioni të pavarur. Për të njëtat arsye, vitin e kalum u përjashtum edhe nga Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Në letrën ku u kumtua vendimi i ENQA's, u tha se AKA s'i përmbushë standardet dhe rregullat evropiane, duke i listu edhe disa prej mangësive kryesore në udhëheqjen e saj.

Ish-kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj a.k.a Rambo, iu pat tekë me shkarku Këshillin Shtetëror të Cilësisë(KShC), menjëherë pasi e mori pushtetin në shtator të 2017'ës.



Pas këtij shkarkimi, ENQA vendosi që Agjencia e Kosovës për Akreditim, mundet me dëgju muhabetin e agjencive tjera, por pa të drejtën e fjalës, bash si nëpër odat e Dukagjinit (ku edhe duket se e kishte mësu qeverisjen Rambo) në të cilat i ndalohet fjala t'riut, e guxojnë të flasin vetëm të vjetrit.

Njërit prej vendeve evropiane me numrin ma të naltë të të diplomuarve të papunë, ENQA e kritikoi për mungesë të punëtorëve, duke thënë se AKA nuk arriti t'i punësojë zyrtarët e nevojshëm për me kry punë.

Me qenë pjesë e këtij asociacioni, për shumë studentë kosovarë nënkuptonte biletë për nji t'ardhme ma t'mirë, përmes së cilës u mundësohej me marrë ma lehtë bursa e m'i vazhdu studimet në universitete të cilat tash mundemi veç me i andrru.

Presioni që iu ba qeverisë Haradinaj, pas shkarkimit të KShC'së dhe pasojave që erdhën me atë vendim, çuditërisht rezultoi me zgjedhjen e anëtarëve të ri të këtij këshilli, përmes një procesi transparent.

Këta anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, nisën m'i grah punës sipas ligjit e detyrave që i kanë marrë. T'punumit drejtë të këtyne anëtarëve, rezultoi me heqjen e akreditimit të dhjetëra programeve studimore, e që besa edhe tërheqjen e akreditimit të tri universiteteve publike, e gjashtë kolegjeve private.

Ani pse anëtarët e rinj u zgjodhën përmes votave të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Rambo nisi m'i akuzu anëtarët që i pati zgjedhë Kuvendi i Qeverisë të cilën ai e udhëhiqte. Ama diqysh u dashke m'i mbrojtë krijimet e partnerit të koalicionit(PDK), që edhe ia kishte siguru karrigën në qeveri, se fundja parja e partia po kanë rëndsi.

Ish-kryetari i PDK'së dhe ish-kryeministri i atëhershëm, Hashim Thaçi, i kishte themelu gjashtë universitete publike, si nevojë e fushatës dhe biletë për pushtet.

Pas luftës së fundit, Kosova e ka pasë vetëm nji universitet publik, Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Në vitin 2009, Thaçi e kishte themelu Universitetin ''Ukshin Hoti'' në Prizren, kah fundi i 2011'ës, kishte marrë vendim për themelimin e universitetit të tretë publik, atij "Haxhi Zeka" në Pejë, vendime këto të cilat i ndihmun për me marrë mandatin e dytë si kryeminstër i vendit.

Dy vite më vonë, u miratu edhe themelimi i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Universitetit ''Kadri Zeka'' në Gjilan dhe Universitetit ''Fehmi Agani'' në Gjakovë.

Veç edhe dy vjet tjera, iu deshën asaj partie, kryeministri e qeverie, që me themelu edhe Universitetin e shtatë publik, atë të Ferizajt.

Pavarësisht këtyre 'investimeve' në arsim, edhe numrit 7, i cili n'shumë kultura t'botës njihet si numër i fatit, universitetet e fushatës s'arritën m'i bind ekspertët ndërkombëtar se kanë cilësi.

Përveç për universitetet publike, dhimta e Rambos ishte edhe tek mosakreditimi i gjashtë institucioneve private të arsimit të lartë, e që natyrisht nënkuptonte humbje e miliona eurove, prej të cilave politikanët s'është bash që s'fitojnë.

Përpjekja e tij, për m'i shku fjala si herën e parë kur e shkarkoi krejt bordin e KShC'së, shtyu ambasadat e Amerikës, Evropës dhe Britanisë së Madhe me iu kundërvy ndërhymjes së dytë të tij, në pavarësinë e këtij Këshilli.

E gjithë kjo zhurmë, mbërriu edhe tek veshi i bordit të ENQA's, të cilët vendosën që Agjencisë së Kosovës për Akreditim, mos me ia vazhdu anëtarësinë, as si anëtarë në vëzhgim. ENQA listoi edhe një varg mangësish ku çalon AKA.

Kësaj agjencie, sipas ENQA's, i lejohet riaplikimi për anëtarësi në të ardhmen, mirëpo kjo mundet me u ba, vetëm pas dy vitesh, edhe atë, duke ia ngrehë veshin AKA-së për m'u përmirësu ama përmirësim serioz.

Studentët që kanë me diplomu tash e tutje, nëse dojnë m'i vazhdu studimet jashtë vendit, kanë me has në vështirësi për me iu njoftë diploma e cilitdo nivel të studimeve, dhe kjo për faktin se nuk ka m'u shqyrtu dosja e tyre duke u bazu në Agjencinë e Akreditimit të shtetit prej të cilit vjen, por në institucionin prej të cilit e ka fitu diplomën.

Pra, nëse i ke përfundu studimet Bachelor në Kosovë edhe synon m'i vazhdu ato Master në ndonjë universitet evropian apo ma gjerë, aplikimi yt ka me hy nëpër filtra dhe procedura që munden me rezultu edhe me mosnjohje të asaj diplome, e që në mënyrë të drejtëpërdrejtë ta pamundëson vazhdimin e studimeve jashtë vendit.

Për këtë ramje drastike, ndjehuni t'lirë m'i falënderu partitë, liderët e tyre edhe ish-qeverinë.

Ma poshtë s'ka ku shkon kolegë!



Liridona Ademaj

mendimtare

" E tash a mi ndal fmitë prej shkolles? "



Adea Kondirolli

mendimtare

Dikush n'vend tonin kish thonë "Qe a pe sheh, e shkarkum kryeministrin". Po na s'po thojmë.

Kjo verë ishte e nxehtë në arsimin e lartë. Gjatë muajit korrik, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, bordi i Agjencisë së Akreditimit, vendosi mos me i akreditu tre universitete publike të Kosovës. Ky vendim erdhi pas vlerësimit të ekspertëve nga ENQA, të cilët vlerësuan që Universiteti i Pejës, i Miztrovicës, dhe ai i Prizrenit, nuk i përmbushin kushtet bazike për t'iu ofruar shërbime studentëve.

Në raportin e vlerësimit të ekspertëve për Universitetin e Pejës mes të tjerash thuhet se ky universitet mund të përmirësohet në të ardhmen, nëse "udhëhiqet nga një menaxhment i informuar dhe i aftë."

Universiteti i Mitrovicës ka shku 1 hap më tutje, duke kopju raportin e vetëvlerësimit prej një institucioni tjetër të arsimit lartë, bile kanë harru edhe me ndryshu emrin diku-diku. Universiteti i Pejës nuk e ka lënë mbrapa në kopjim, duke kopjuar misionin e universitetit nga një universitet tjetër në masën 53%.

Ekspertët kanë evidentuar edhe mungesë të thellë të transparencës në këto universitete, ku shumë rregullore nuk janë të publikuara në uebfaqe. Këtë e vërtetojmë edhe ne, përmes afateve të provimit janar dhe shtator.

Si përfundim, KShC e miraton raportin e ekspertëve, edhe nuk i akrediton institucionalisht tri universitetet. Kjo, përkundër fejk-njuzave gjatë kësaj periudhe, nuk është e vërtetë që kemi mi ndalë fmitë (ekzistues) prej shkollës. Studentët që vijojnë studimet në këto tri universitete, të regjistruar në vitet paraprake, vazhdojnë mësimin sipas programit që kanë. Kjo i bjen që universitetet nuk mund të regjistrojnë studentë të rinj për vitin akademik 2019/20. E për vitin tjetër, flasim.

Këtë vendim të KShC-së nuk e mirëpriti kryeministri jonë në largim, Ramush Haradinaj. Ai akuzoi anëtarët e KShC-së që janë pjesë e bandave mafioze (what?), edhe që po i lojnë rrugëve fmitë e varfër të Dukagjinit e të Mitrovicës.

Për këtë, ORCA vendosi me bo një aksion kundër presionit që i bënte kryeministri e ministri i arsimit KShC-së. Me pyetjen "Kush o ma i forti?" na tregum që edhe pse kryeministrin munden me thirrë Rambo, KShC-ja është ma boss, pasi që ka më shumë vota nga Parlamenti se ai, respektivisht 15 vota më shumë (mos t'i harrojmë rezultatet e këtyre zgjedhjeve :)

1 ditë pas, kryeministri dha dorëheqje. Dikush n'vend tonin kish thonë "Qe a pe sheh, e shkarkum kryeministrin". Po na s'po thojmë.

Në mbledhjen e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të datës 16 shtator, anëtarët vendosën që ankesat e universiteteve t'hidhen poshtë. Suksese herave tjera!

Perla nga arsimi i lartë

GJETJE THESARI DHE COPËZA ILUMINIMI NGA BËRTHAMA E DITURISË



Indrit Ferati

Kolegji e plotëson kushtin e fundit për akreditimin!



Kolegji AAB e ka mbushur zbrazësinë në cilësinë e arsimit, me rritje të cilësisë në vozitje. Instruktorët e vozitjes janë profesorët që marrin honorare shtesë. Kolegji ka siguruar gjashtë "FA-VE"-ja 2.0 dhe më e rëndësishmja: ato e kanë TDI-në e kuqe. Disa studentë ishin ankuar se kfaqillën duhet ta lëshonin ngadalë, pasi makinat po ngrehnin shumë gjatë vozitjes. Testi i vozitjes monitorohet nga rektori i kolegjit dhe marrja e lejes së vozitjes rezulton me 6 kredi për studentin.

Revistë shkencore		
Titulli i punimit	*Emri i revistës*	*Viti/Nr./Faqe*
Afrim Selimaj, *Zhvillimi i Turizmit në Komunën e Pejës interes për Kosovën.*	*Gazeta e përditshme "Pavarësia news" Prishtinë*	*Viti 2006/faqe 8*
Afrim Selimaj, *Bizneset e vogla e mbajnë gjallë popullatën dhe e zbusin papunësinë alarmante.*	*Gazeta e përditshme "Pavarësia news", Prishtinë*	*Viti 2007/faqe 5*

Afrim Roboti

O Afrim o punim-shkrues,
me ksi' publikime po del dyshues,
revista shkencore po kërkon mileti,
gazetat e përditshme jo me i bo për veti,
pesë gishta i ka njerzimi,
pesë punime i kërkon avancimi,
pesë gishta i ka një dorë,
Me 28 Nëntor flamuri u ngrit në Vlorë

*Marrë nga CV-ja e prorektorit në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka"

Epoka e akullnajave

Shkathtësitë kompjuteri dhe kompetencat:	Windovs 98,MS Word 2000-I,II, Exel 2000-1

Mercedesi old school është cool, farmerkat old school janë cool. Këto janë disa pluse për të qenë staf akademik në Universitet Publik, por jo përdorimi i Windows 98 pas 21 vjetësh. Sa shumë do të ofendohej kompjuteri i ri në Universitet, i cili është blerë nga taksat tona, për t'u përdorur nga i nderuari profesor, i cili paguhet po ashtu nga taksat tona. Profesorit në fjalë, i sugjerojmë që të pres edhe disa vite, pasi nuk i dihet nëse Windows 98 do të cilësohet si cool.

Shpella e Prizrenit

Kjo është letra jonë që e kemi nisur me
pllum nga Tempulli i Dijes për Prizren:

"I nderuar Universitet i Prizrenit,
Ne e kuptojmë dhe e besojmë fuqishëm se vetëbesimi është kyç në mirëmbajtjen e cilësisë që ju e posedoni. Për fat të keq, KShc ka marrë vendim që institucioni juaj për këtë vit akademik, të mos akreditohet. Paçi fat në vitin tjetër dhe MOS HARRONI ta mbani me veti syrin e kaltërt të msyshit. Shihemi në vitin tjetër!

Me respekt,
Tempulli i Dijes".

IOSR Journal of Sports and Physical Education (IOSR-JSPE)
e-ISSN: 2347-6737. p-ISSN: 2347-6745. Volume 4, Issue 5. (Sep - Oct 2017). PP 34-42
www.iosrjournals.org

Historical –Political Aspects of Development of the Albanian Alphabet Until 1870

Prof. Assoc. Dr. Fahredin SHABANI,
(University of Prizren. Kosovo)

Revista " Topi "


O Fahredin,
ham profesor ham sportist,
në punim tregove sa shumë je profesionist,
alfabetin tonë e dërgove në fushë futbolli,
aspekti politik i tij Ronaldos i ndihmoi,
Ronaldo me fellq topin e plasoi,
shënoi rrjetën, u ul ne gjunjë dhe tha,
Fahredini më mësoi

Tempulli i Dijes: monografi 1970-2012, Co-autor në monografinë kushtuar Universitetit të Prishtinës, Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2012, ISBN 9789951001458

Tempulli i Dijes jemi ne

Në shtetin tonë janë dy Tempuj të Dijes. Njëri është kogja serioz, kurse tjetri nuk duhet marrur shumë seriozisht. Lexuesit tanë (loçkamanët) e dijnë se ne do të luftojmë deri në fund që emri jonë të mos keqpërdoret nga pala jo-serioze. Edhe pse me një çmim të arsyeshëm, ne kishim mundur ta ndërrojmë emrin në "Shupa e Dijes", "Plemja e Dijes", "Shpajzi i Dijes" etj.

*Marrë nga CV-ja e një profesori në Universitetin e Prishtinës



E FUNDIT: Zbulohet përse në Kosovë nuk ka punime shkencore (FOTO)

Më në fund është zgjidhur dilema se pse profesorët tanë nuk kanë punime shkencore. Një revistë shumë shumë e rëndësishme, është e indeksuar nga platforma Instagram. Kështu profesorat që kanë publikuar në Insta-Story, punimet e tyre janë fshi pas 24 orëve. I këshillojmë profesorat që herën tjetër ta ruajnë story-n dhe ta publikojnë në revistë tjetër.

1 TETORI

22 vjet nga protesta e 1 tetorit 1997

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës në vitin 1989 dhe përjashtimit të studentëve dhe profesorëve shqiptarë nga hapësirat universitare në vitin 1991, Universiteti i Prishtinës hyri në sistemin "ilegal" paralel. Në vitin 1997, filloi një organizim studentor më i theksuar sa i përket përpjekjes për rikthimin e hapësirave universitare. Edhe pse sistemi paralel vazhdoi deri në vitin 1999, protesta studentore e vitit 1997, paraqet një moment të rëndësishëm në historinë e Universitetit të Prishtinës.



Organizimi

Organizimi për protestë filloi nga shkurti i vitit 1997. Data e protestës u vendos të jetë 1 tetor, si datë simbolike e fillimit të vitit akademik. Për gjashtë muaj organizatorët e protestës mbajtën takime me studentë, me subjekte politike, grupe kulturore e arsimore, intelektualë dhe me diplomatë të huaj (Muhamet Mavraj, TD2). Pjesë e rëndësishme e organizimit ishin edhe takimet dhe diskutimet me studentët e fakulteteve dhe shkollave të larta jashtë Prishtinës. Këto takime bën që të ketë një mobilizim të gjerë studentor. Në shtator, Unioni i Pavarur i Studentëve themeloi këshillin organizativ dhe platformën e protestës e cila ndër të tjera kishte dy pika kryesore: "Protestat e studentëve janë organizuar për të çliruar objektet dhe hapësirat e Universitetit tonë të okupuar nga regjimi serb që nga viti 1991" dhe "Protestat janë të studentëve, paqësore dhe jo të dhunshme" (Milot Cakaj, Kosovo 2.0, 2017). Në organizim, përveç studentëve morën pjesë edhe profesorët, madje edhe vetë rektori i atëherëshëm i Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci.







Protesta

Me parullat "Merrni frymë sikur ne studentët", "Lirim pakusht i objekteve universitare" dhe "Hello Europe, where are you?" ndër të tjera, studentët marshuan nga rektorati, që atëkohë ndodhej në lagjen Velania, dhe vazhduan në rrugën që tash mbanë emrin "1 Tetori". Marshi, edhe pse paqësor, nuk arriti të përfundonte, u ndërpre dhunshëm nga forcat e regjimit të Millosheviqit. Pjesëtarë të policisë dhe të sigurimit sekret serb, filluan të sulmonin protestuesit, organizatorët, rektorin Statovci dhe turmat e gjera të studentëve. Ky intervenim, përfundoi me arrestimin e disa prej organizatorëve. (Bujar Dugolli, 1 Tetori i kthesës, 2013)



Skord Retkoceri
mendimtar

Për të parë pjesë nga intervista me disa nga protagonistët kryesorë të protestës studentore të vitit 1997, mund të lexoni numrin e dytë të TD-së në: www.orca-ks.org

Pas protestës

Kjo protestë, bëri që Kosova të ketë vëmendje edhe në arenën ndërkombëtare. Përveç nga qytetarët e Kosovës, protesta u përkrah edhe nga organizata ndërkombëtare, grupe studentore evropiane, medie ndërkombëtare dhe diplomatë. "Vdekja e mitit të frikës, fundi i politikës pasive dhe pakthyeshëm provokimi i tensioneve që do t'ia hapte derën Perëndimit për ta ndihmuar Kosovën" sipas Muhamet Mavraj, ishin disa nga ndikimet që ka pasur kjo protestë (TD2).





Pas 22 vjetëve, ORCA vazhdon marshin

Në 22 vjetorin e protestës studentore të vitit 1997, ORCA organizoi marsh simbolik për të vazhduar marshin që u ndërpre nga forcat e regjimit të Millosheviqit. Studentët marshuan nga ish-rektorati deri tek Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Pjesëmarrës në këtë marsh ishte edhe Xhevdet Shoshi, pronari i shtëpisë të cilën e kishte lëshuar për ta përdorur si rektorat të Universitetit në vitet e 90-ta.



NJË SY UNIVERSITETIT

Prej vitit 1980, deri 2018 Universiteti i Prishtinës i ka publiku veç 1735 punime shkencore që i plotësojnë kriteret aktuale. Vitin 2017 e ka pasë ma t'suksesshmin, me gjithsejt 220 punime shkencore. Fakulteti me ma s'shumti punime shkencore është Fakulteti i bujqësisë dhe veterinarisë, me mesatarisht 8 punime për kokë profesori.

Në anën tjetër, ka edhe asi që nuk e shohin si t'nevojshme korrektësinë edhe integritetin akademik. Jonë t'kënaqun edhe me publiku punime sa për sy e faqe nëpër revista mashtruese, me t'cilat mundohen me i arsyetu titujt akademik. Fatkeqësisht, veç në periudhën 2007-2018, 153 profesorë kanë publikuar 502 punime në revista mashtruese.

502
punime në revista mashtruese

1980
1990
2000
2007
2018

1735
punime të vlefshme

viti 2017 është viti me më së shumti publikime, gjithsejt 220 punime shkencore. Fakulteti me më së shumti punime shkencore në UP është Fakulteti i Veterinarisë dhe Bujqësisë.

Nga 465 profesorë me tituj akademikë, 208 nuk e kanë asnjë punim të vlefshëm sipas kritereve aktuale. Po, kjo osht përafërsisht çdo i dyti profesor pa asnjë punim të vlefshëm.

nga 465 profesorë

0 0 0

çdo i dyti
nuk e ka asnjë punim të vlefshëm sipas kritereve aktuale

Rrjedhimisht, 276 profesorë, apo 59%, nuk i justifikojnë titujt akademik që i mbajnë. E për me e ndreqë hala ma shumë, 105 prej tyne janë Profesorë t'Rregullt, titulli ma i naltë akademik, çka ju siguron atyne kontrata të përjetshme të punës.

16 profesorë i kanë vjedhë punimet shkencore

13 dekanë nuk e kanë pranuar se janë në dijeni për rastet

0 dorëheqje

9 janë avansuar edhe pas publikimit të lajmit për vjedhje

3 janë suspenduar por janë kthyer prap

Po, nganjëherë edhe me e shkru nji punim për revista mashtruese mundet me tu dokë punë e madhe. Shumë ma lehtë osht, përshembull, me ia vjedhë punimin dikujt tjetër. N'botën akademike vjedhjes së pjesshme apo t'tërësishme t'veprës së dikujt i thuhet plagjiaturë.

276
nuk i justifikojnë titujt akademik që i mbajnë

105
nga ta janë profesorë të rregullt me kontrata të përhershme

Edhe pse nuk ka ndonji hulumtim t'thuktë për numrin e saktë të plagjiaturave në UP, janë 16 raste të njohura t'cilat janë raportu n'media. Sado që plagjiatura është kategorikisht e ndaluar në bazë të Kodit të Etikës, Rregullores për Masa Disiplinore, Statutit të Universitetit e bile edhe Kodit Penal, shumica e profesorëve të përfshirë nuk e kanë pa t'nevojshme as me reagu ndaj akuzave. Për dorëheqje, as që vjen n'shprehje.

Edhe 13 dekanët e fakulteteve të UP-së, kur janë pyet n'lidhje me këto raste, thjeshtë kanë thanë që nuk janë n'dijeni për ndonjë rast të plagjiaturës.

Prej 16 këtyre rasteve, vetëm 3 janë suspendu, mirëpo t'tretë janë kthy prap, përveç njërit që nuk ka qenë mësimdhënës i rregullt e i është ndërprre kontrata.

POLITIZIMI VAZHDON



Dibran Hoxha
mendimtar

Rene Dekarti (Rene Descartes) ishte ndër filozofët e parë të modernitetit, i cili në librin e tij "Përsiatje Metafizike" erdhi në përfundim se ekzistojnë dy substanca themelore: trupi dhe shpirti.

Sipas Dekartit, trupi ka atribut shtrirjen, kurse shpirti ka atribut mendimin. Por, a e keni mendu najher se ka persona me angazhime publike në Kosovë që e hudhin poshtë teorinë e filozofit. Në vendin tonë t'dashtun ka persona që të njejtën kohë mbajnë pozitën e profesorit në Universitet pubilk, deputetit në parlament (ose pretendojnë me qenë), ligjërues në naj kolegj privat, këshilltar në naj parti politike edhe punët e shpis' kuptohet.

Dualizmi substancial nuk është trup-shpirt o zoti Dekart, por, trup-trup. Domethënë personat e listuar më poshtë janë 2, 3, 4 trupa në vende të ndryshme në të njejtën kohë, gjithashtu këta trupa nuk i karakterizon as shtrirja as mendimi*.

Pra, ne kemi hulumtu se cilët kandidatë të listave për deputetë, nga të gjitha partitë në garë, punojnë edhe në universitete publike si profesorë apo asistentë dhe rezultati është ky:

PDK	11 kandidatë;
LDK	11 kandidatë;
AAK-PSD	7 kandidatë;
VV	5 kandidatë

që punojnë si profesorë apo asistentë në universitete publike.

Nuk është se ne ja kemi inatin "gjenive" tanë. Veçse, ka disa arsye prej 8 orësh. Është e pamundur që dikush ta kryejë këtë punë mirë, kur ai/ajo ka një angazhim po ashtu shumë me rëndësi siç mund të jetë ai i deputetit të Republikës, apo i funksionarit tjetër shtetëror a partiak. Pastaj lind pytja: prof. pse me i nënshkru katër lista n'ligjëratë kur na veç njo pe mbajna?

Tjetra, papunësia tek të rinjtë në vendin tonë është 54%, që i bie që çdo i dyti nga radhët tona është i papunë, gjersa një funksionar shteti i merrë 2 e më shumë paga nga buxheti i shtetit. E natyrshme kjo meqë pse këto të gjetuna rezultojnë të jenë shqetësuese.

E para: Puna si profesor apo asistent në universitet, kërkon përkushtim të madh. Ajo është punë me orar të plotë punë me orar të pjesshëm. Është e pamundur që dikush ta kryejë këtë punë mirë, kur ai/ajo ka një angazhim po ashtu shumë me rëndësi siç mund të jetë ai i deputetit të Republikës, apo i funksionarit tjetër shtetëror a partiak. Pastaj lind pytja: prof. pse me i nënshkru katër lista n'ligjëratë kur na veç njo pe mbajna?

Tjetra, papunësia tek të rinjtë në vendin tonë është 54%, që i bie që çdo i dyti nga radhët tona është i papunë, gjersa një funksionar shteti i merrë 2 e më shumë paga nga buxheti i shtetit. E natyrshme kjo meqë ata kanë shkri men' për këtë punë, qe besa dikush edhe pare.

Dhe e fundit, deputetët dhe qeveritarët që punojnë edhe në universitet, janë vet politizimi i arsimit. Të gjithë e dimë profesionalizimin e profesorëve tanë, se sa objektiv janë ata në mbarëvajtjen e proceseve mësimore në Universitet, (pak kungja opozitarëve, pak lëvdata partisë së tij, u kry kjo punë).

Thënë këto, ORCA konkludon se pavarësisht pallavrave të partive për luftën kundër punësimeve nepotike e partiake, realiteti që shihet në listat e tyre është ndryshe. Ato vazhdojnë të mos pajtohen me kapjen e institucioneve arsimore nga partitë kundërshtare, por jo nga anëtarët e partive të veta.

Më e pakta që ato mund të bëjnë tash pas zgjedhjeve është: profesor, deputet, babë, nanë, motër, vlla, paçi fat.

**P.S*
Përjashtim bën Blerand Stavileci i cili ka deklaru se punon 25h në ditë, Blerandi jeton në dimensione tjera metafizike hapësirë-kohë, mbetemi jashtë universit të tij përderisa nuk ia gjejmë formulën.

LDK
- Vjosa Osmani - UP
- Kujtim Shala - UP
- Avdullah Hoti - UP
- Hykmete Bajrami - UP
- Muhamet Hamiti - UP
- Haki Demolli – UP
- Rexhep Gjergji - UP
- Sevdije Alshiqi - UP
- Marigona Geci Lala - Prizren
- Ibish Mazreku - Pejë
- Mimoza Shahini – Mitrovicë

PDK
- Hajredin Kuçi - UP
- Eliza Hoxha - UP
- Idriz Vehapi - UP
- Ferat Shala - UP
- Ramë Vataj - UP
- Gentiana Beqa Ahmeti - UP
- Blerim Latifi - UP
- Ilir Kurtishi - UP
- Kadri Kryeziu - Prizren
- Sabiha Shala - Pejë
- Sejdi Hoxha - Ferizaj

AAK - PSD
- Afrim Hoti - UP
- Salih Salihu - UP
- Albena Reshitaj - UP
- Driton Çaushi UP
- Naser Pajaziti UP
- Besa Luzha UP
- Besim Muhadri – Gjilan

VV
- Shpejtim Bulliqi - UP
- Fitim Uka - UP
- Sabri Kiçmari - UP
- Driton Vela - UP
- Besa Berberi - Pejë

PARTIA ⇆ UNIVERSITETI



Liridona Ademaj
mendimtare

"Partia-Universiteti-Partia", kjo është formula e famshme përmes të cilës, universitetet publike po furnizohen me intelektualë e dijetarë, për m'i udhëheq Këshillet Drejtuese (KD), e që mandej atë dije, me ia transmetu shokëve t'partisë.

Vetëm gjatë këtij viti, kemi pa plotë transfere nga parti të ndryshme për në Këshillet Drejtuese të universiteteve publike.

Natën e Vitit të Ri 2019'të, ministri i Arsimit në largim, Shyqiri Bytyqi pati vendosë që Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan dhe Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", me ua dhuru ca anëtarë të partisë Nisma, për Këshill Drejtues.

Mes tyne pati profesorë universitar, mësimdhanës të shkollave fillore(që m'u siguru se studentat e profesorat s'i kanë harru ato që i kanë pas m'su ma herët), pati edhe ish-drejtor të Shërbimit Korrektues(e ky ka qenë transfer i fortë, dikush duhet me rujtë cilësinë në universitet).

Pati edhe zyrtarë administrativ të partisë, edhe profesorë të aderuar nga PDK'ja për në Nisma, por edhe ish-asamblist të PDK'së.

E tash, ti je tu mendu qysh krejtë këta anëtarë të Këshilleve Drejtuese, përmes partisë paskan hy në universitet?! Ama pyetjes tande veç iu ka përgjigjë profesori i Universitetit të Mitrovicës, Muzafer Shala.

"Qysh me hi n'punë pa qenë në parti?", deklaroi ai gjatë një debati parazgjedhor. Pyetje me vend për besë profesor, mirëpo hala s'kemi përgjigje.

Ndërrimi i partisë dhe koalicioni me një tjetër, e detyruan ministrin që me vazhdu me emërime të tjera politike në Këshille Drejtuese. Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj dhe në Universitetin e Gjilanit, emëroi edhe nga dy anëtarë të AAK'së. Ndërkaq në Universitetin e Prishtinës, i cili është universiteti publik ma i vjetër në Kosovë, gjatë këtij viti u zgjodhën pesë anëtarë të KD'së, ku dy prej tyre dyshohet se u rizgjodhën në mënyrë të jashtëligjshme. Kjo rizgjedhje e tyre për herë të tretë, e që është n'kundërshtim me Statutin e UP'së, mundet m'u përkthy vetëm si kthim i favorit ndaj këtyre anëtarëve, të cilët votuan për zgjedhjen e rektorit, prorektorëve dhe sekretarit të përgjithshëm.

Natyrisht që politika s'ndalet vetëm tek profesorat e anëtarët e Këshilleve Drejtuese, se gjithqysh kalon kah fuqia udhëheqëse e menaxhmentit e rektoratit, se s'është bash lehtë m'u zgjedhë rektor, prorektor, e sekretar i përgjithshëm i nji univeristeti publik, ama këto ua përsërisim herave tjera.

MENDOJ

Leonidi socialist i MASHT



Gramos Buçinca
mendimtar



Zt. Arsimit, në kohën kur arsimi në Kosovë u përballë me telashe të mëdha: greva destruktive e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shkencës dhe Kulturës; shkarkimi i të gjithë anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë nga Kryeministri - gjest ky që e përjashtoi Kosovën nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë; dhe akuza të profesorëve për cenim të autonomisë pasi që u vendos standard për definimin e publikimeve shkencore në nivel vendi. Ministri po ashtu u ballafaqua me shantazhim nga mashtruesit, pronarë të kolegjeve private që iu hoq akreditimi, si dhe me shumë probleme të tjera brenda ministrisë.

Ndonëse disa nga këto beteja ende vazhdojnë, në shumë prej tyre z. Bytyqi korri fitore Pirrike. Pra fitoi, por mbeti i shpërfillur nga partia e tij, NISMA, e cila jo gjithmonë mbrojti cilësinë në arsim. Kjo paevitueshëm erdhi deri tek dorëheqja e tij nga kjo parti, gjë që e çliroi atë t'i shpreh bindjet e veta me elokuencë. "Të shumtë do jenë që do e tumirin dorëheqjen time dhe po ashtu të shumtë do jenë që do ngatërrohen në hilen se unë nuk erdha ta bëja ministrin e Arsimit nga pesha reale brenda partiake, por nga koniunktura në hirin e një shkolle të cilën e trashëgon tashmë ish kryetari i partisë ku mihitoja deri sot." dhe "E majta që jeton në mua po aq sa ishte bindja ime tashmë është bërë edhe rrugëtimi im angazhues!" – shkroi ndër të tjera z. Bytyqi në letrën e dorëheqjes së tij.

Mbase edhe do ta kurseja nga ajo që do të them në fund po që se ai nuk do t'shkruante: "...unë nuk e shoh të udhës të vazhdoj atje ku duhet ta bëjë bashkëspartanin me gjithë ata që çdo ditë duhet ta mbrojnë partinë nga gabimtarët e brendshëm!". Kjo fjalë "bashkëspartanët", e pa lexuar ma herët, m'ngacmoi pak.

Qëndresa e spartanëve kundër persëve dhe mënyra e thjeshtë por e virtytshme e jetesës së tyre ishte aq legjendare sa influencoi njerëz dhe lëvizje të të gjitha ideologjive. Kush mundet me harru mbretin Leonidas, që kur njoftohet se persët kanë aq shumë shigjetarë sa do ta bllokojnë Diellin tha: "A s'do të ishte më mirë po të luftonim nën hije?", gjersa me 300 luftëtarë spartanë në Termopile, priste pa shpëtim qindra-mijëra sosh persë. Sokrati, Aristoteli, Machiavelli, Rousseau e Adams mendonin se shoqëritë ku jetonin ata, do të ishin më të mira po ta merrnin si shembull Spartën. Revoulcioni francez që e ndryshoi tërësisht sistemin politik në botën perëndimore, qe ndikuar prej këtyre mendimtarëve lakonofil (kështu quhen adhuruesit e Spartës antike). Makineria shfarosëse e Gjermanisë Naziste përdori shembullin se si 6 mijë qytetarë vendas spartanë, racë e pastër, kontrollonin mbi 300 mijë Helotë skllevër. Pra, lirisht mund të themi se këto përdorime të lavdisë së Spartës, e definuan historinë e botës perëndimore të paktën. *(shënim i redaksisë: "Ani Gramos ani")*

Andaj kur përdoret Sparta kundër partisë Nisma Social Demokrate e Kosovës, qare nuk ki pa u shtri tu qeshë. E kjo e qeshmja t'bëhet vaj, në momentin që e kupton se intrigat brenda një partie pothuajse të papërfillshme dhe në Kosovën modeste, një ministri të shtetit i duken si beteja spartanësh.

KRONIKA E ZEZË



Zogë Hasani

ORCA me "thupër" kujdestaron integritetin akademik (kush s'e lavdon

[redacted]

Njësiti special i ORCA-s pas një operacioni që e kishte bërë në muajin shtator të 2018, rreth revistës mashtruese Journal of Pharmaceutical Sciences Review and Research, revistë në të cilën disa profesorë të Universitetit te Prishtinës kishin publikuar aty, arriti ta demaskonte revistën mashtruese, duke dërguar një punim me 0% përmbajtje shkencore, me autor Rrush Kalaveshi. (shih TD2)

Pas publikimit të saj Profesori i Fakultetit te Shkencave Matematiko-Natyrore, Ilir Shala i cili e kishte deklaruar veten prodekan, pa qenë i tillë, përveç që nuk hoqi dorë nga mashtrimi i tij është munduar që ta fsheh rastin duke e shantazhuar atë e duke i kërkuar që punimin e Rrush Kalaveshit ta heq nga faqja e vet dhe duke kërkuar fletëpagesën bankare për ta kuptuar se kush fshihet pas këtij shkrimi.

Njësiti special doli të jetë shumë i suksesshëm, pasi që Këshilli i Etikës ka marrë vendim për shqiptimin e masës "vërejtje me shkrim" për profesor asistent Ilir Shehu, pasi ka aprovuar denoncimin e ORCA-s të bërë me 14 shtator 2018.

Siç është konstatuar edhe në vendimin e Këshillit të Etikës me numër 2/178 i datës 23 korrik 2019, pas denoncimit nga ORCA të revistës "International Journal of Pharmaceutical Sciences Review" për praktikat mashtruese pasi kjo revistë botoi punim e autorit fiktiv Rrush Kalaveshi, Senati e futi këtë revistë në listën e revistave të dyshimta.

Urojmë që kjo vjeshtë të jetë e bereqetshme për vreshtarët sikur se për Universitetin.



Rambo terrorizon fëmijët

Një qytetar nga Lipjani ka dërguar foto ku shihet një billboard i Ramush Haradinajt në oborrin e shkollës 'Vëllezërit Frashëri' raporton KALLXO.com

Siç edhe shihet ky billboard përmban shumë informacione të vlefshme shkollore. Histori, biologji, matematikë me disa përqindje (11% për 100%). Përveç kësaj, vendosjen e këtij bilboardi e bën skandaloz edhe fakti se ai është vendosur pa filluar fushata zgjedhore, gjë që është e ndaluar sipas nenit 33 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Shpresojmë që në zgjedhjet e ardhshme kjo parti të jetë më e dureshme dhe njohuritë e përgjithshme t'ia lë lëndëve shkollore e jo billbordave partiak.

Privatet lëshojnë diploma të pavlefshme

Disa institucione të arsimit të lartë në Kosovë kanë kryer shkelje të rënda ligjore duke mos dorëzuar regjistrat e të dhënave të studentëve të tyre në MASHT. Kjo do të thotë se këto institucione kanë regjistruar studentë përgjatë kohës që nuk kanë qenë të akredituar ose kanë regjistruar studentë përtej numrit të lejuar, bazuar në vendimet e Agjencisë Kosovare të Akreditimit.

Mijëra studentë të cilët kanë ndjekur studimet në këto institucione mund të jenë pre e këtij mashtrimi. Kësisoj, diplomat e marra nga këto institucione nuk kanë bazë për t'u njohur në Kosovë apo jashtë saj.

Presim që kjo çështje të zbardhet nga organet kompetente dhe shkelësit të vendosen para drejtësisë. Po ashtu, ne presim që studentët viktima të këtij mashtrimi t'i drejtohen organeve të hetuesisë apo gjyqësisë duke ushtruar padi dhe kallëzime penale për institucionet që i kanë mashtruar ata.

Ndërhyrja ndërhyrjen s'e pritke


Pas intervenimit te ambasadave te caktuara, në çështjen e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, ORCA kërkon nga ambasadat që të mos interferojnë në çështjet e brendshme të institucioneve të Kosovës në mënyrë të pasinqertë.

Roli i ambasadave është që t'i përfaqësojnë interesat e shteteve të tyre dhe entiteteve të tjera që mund të vijnë nga shtetet e tyre, por kjo nuk mund të bëhet në kurriz të cilësisë së arsimit të lartë në vendin tonë. Nëse interesat e entiteve që përfaqësohen nga cilado ambasadë janë në shpërputhje me interesin publik në Kosovë, ambasadat duhet të përmbahen dhe të tregohen të matura në reagim.

Ne i bëjmë thirrje të gjithë akterëve në vend, kombëtar e ndërkombëtar që ta mbështesin pa kushte Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe proceset nëpër të cilat po kalon ajo.

"Hajt se përpak s'e kena kqyr"

Në vitin 2006 Zeqir Veselaj kërkon nga MASHT-i që t'ia nostrifikojë doktoraturën me titull "Mycoflora në disa masive pyjore të Kosovës", kësisoj MASHT kërkon vlerësimin e një komisioni për këtë doktaraturë e të gjeturat e këtij komisioni thonë se në kapitujt ku bëhet fjalë mbi njohuritë për vegjetacionin kandidati i ka kopjuar tërësisht nga dr. Ferat Rexhepi. Megjithëkëtë, MASHT-i e nostrifikon diplomën e Veselajt madje me moton "hajt se përpak se kena kqyr" ai vazhdon të ligjëroj në fakultetin e edukimit, e si "asnjëherë" më parë ai edhe shpërblehet duke u avancuar në profesor të asocuar. E kish pasë vet babgjyshi jem stërgjyshin "babë, ça do mu bo me neve kshtu vllavi jem krejt llugë" përgjigja e tij dhe me kaq po e përmbyllim ka qenë "hajt djali jem se ko mu bo mirë" e edhe unë po thom që ko mu bo mirë. Rrnoftë Kosova* (mthanë ndërkombtarët me qit fusnotën se qashtu pe lyp puna, po ju pe dini që dashta me thanë "Rrnoftë Kosova Republikë".)



Kronika Rosé

AFORIZMA
Pruri et Rosé në parti, burim i dijes

Vesel Veseli
mendimtar



astrologjia universitare

Filozofi
—Fakulteti Filozofik



Kohëve të fundit jeni në mëdyshje, herë ndjeheni si Toni (Platoni) e herë si Teli (Aristoteli). Por a jeni ju një filozof, politolog, sociolog, punëtor social, psikolog, historian, apo vetëm studiues të këtyre lëmive? Përgjigja do t'ju shfaqet në një filxhan makiatoje pa shumë sheqer. Ju që keni besuar në Zot, do të filloni të keni dyshime, kurse ju që nuk besuat, do të filloni të dyshoni gjithashtu. E a nuk ju thamë ne, se ju do të dyshoni? Dysho, sepse je, por mos dysho në dyshimin. Megjithatë ju jeni me fat. Ju keni fatin t'ju udhëheqin në këtë aventurë akademike, profesorë eminentë si: Ibrahim Gashi - i cili në vitin 2014 ishte rektor, por u shkarkua sepse u zu me pelë për dore në çështje të mashtrimit akademik; Arsim Canolli - antropolog, ekspert i flijave; Shemsi Krasniqi - sociolog, i cili shpjegon ndërhyrjet e shoqërisë civile në luftën kundër korrupsion në UP duke e krahasuar me ndërhyrjet e Millosheviqit në vitet 1990. Fati i tillë ju përcjelltë gjithmonë!

Mekanisti
—Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike & Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike



"Kojshi ni grijaq i bojlerit diçka nuk po nxen", "Tezak, djalit iu ka prish gjustiku i sonit diçka",
"Kusho, çka mi bo qisaj llamelle t'pezhos bre". Këto do t'i përjetosh gjatë gjithë jetës nga njerëz që e keqkuptojnë profesionin tënd. Injoroj të gjitha këto, Hëna është në vijë me yjësinë tënde, prandaj shih drejt të ardhmes, një gjë pozitive po vjen.

Ekonomisiti
—Fakulteti Ekonomik



Kohëve të fundit do të keni probleme financiare. Një kredi do t'ju bënte mirë. Do të kuptoni më mirë si funksionojnë bankat në Kosovë e pse jo edhe të menaxhoni paratë. Kujdes, shenjat yjore nuk janë në anën tuaj, mos e ngatërroni kredidhënien me fajde, qoftë edhe nëse institucioni që e jep atë quhet bankë.

Mësuesja
—Fakulteti i Edukimit



Repetitio est mater studiorum - thotë fjala latine që do të thotë - Përsëritja është nëna e mësimit. Përsërit "Ne duhet të përmirësohemi në PISA. Ne duhet të përmirësohemi në PISA. Ne duhet të përmirësohemi në PISA. Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA.Ne duhet të përmirësohemi në PISA."

Sportisti
—Fakulteti i Edukimit Fizik dhe Sportiv



Dimri po afrohet, së shpejti do të udhëtoni diku. Nëse ju kruhet dora e djathtë, shpenzimet do t'i paguani kryesisht ju, nëse e majta atëherë ka shanse që i paguani me dy duar. Skijim, apo not? - kjo është çështja.

Arkitekti dhe Ndërtimtari
—Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Një ndarje e madhe ka ndodhur, mundohuni ta gjeni veten sa më mirë në këtë ndarje. Mund të jetë divorc i dikujt në rrethin tuaj apo edhe i ndonjë institucioni që ka lidhje me ju. Zonja Ini nga ORCA ka lexuar kafenë tuaj që ende s'e keni pirë, aty po ndodh një lëmsh: tre zallë, një cement. Përgatituni!

Gjuhëtari
—Fakulteti Filologjik



Në fillim ishte fjala.
Ky muaj do të filloj me vështirësi. Të mësosh një gjuhë të re do të thotë të pranosh kërkesa nga rrethi i gjerë se si të shajmë në gjuhën të cilën e studioni. Kurse nga familjarët, do të thotë se ju duhet të flisni gjuhë të huaj para musafirëve në shtëpi. Spanjishtja është shtuar si gjuhë që mund të mësohet në Fakultetin tuaj. ''Donde esta la biblioteka" ''Por amor de Dios Maria, eres tu iha" ''Noooo, estoj embarasda kon tu marido" - ishin këto reminishenca nga koha e telenovelave.

Shkencëtari
—Fakulteti i Shkencave Natyrore



Këtë muaj keni dëgjuar shpesh për rinumërimin. Edhe për "pragun" dhe "nismën". Nisma e universit ishte big bangun kur pragu u kalua përmes shpërthimit, gjithçka pastaj ishte numër, e numrat u bënë trupa, e disa nga ta u ngjallën, e disa u shpërbënë dhe prapë gjithçka do të përbëhet, të gjallët do të vdesin, trupat do të bëhen numra, e numrat shpërthim invers, pragu nuk do të kalohet e KQZ megjithatë do të vazhdojë të rinumërojë. (nKofsh bektesh e merr vesh)

Mjeku
—Fakulteti i Mjekësisë



Më i miri, më i zoti i familjes je ti. Prandaj je dërguar për tu bërë mjek. Ti je ajka e shoqërisë. Ti na shëron zemrat, e zemra jote vuan për atë të shkollës së mesme që ka mbetur pa u regjistruar në fakultet. Ti do të fillosh ta mësosh gjuhën gjermane dhe në shpirtin tënd do të lind urrejtja për vendlindjen tënde. Këtij fenomeni i erdh fundi! Kohëve të fundit do të përballesh me oferta për ta mësuar gjuhën gjermane. Kujdes! Kjo mund të ta ndryshojë jetën, prandaj mendo mirë nëse do ta mësosh këtë gjuhë apo jo.

Juristi
—Fakulteti Juridik



Këtë muaj do të keni probleme me frymëmarrje. Ju jeni tepër shumë studenta. Ju që keni probleme me klaustrofobi, fobinë do t'ua heq stresi nga provimi "E Drejta Romake", ndërsa ju që nuk vuani nga klaustrofobia ka shumë gjasa ta fitoni atë duke provuar ta gjeni emrin tuaj te lista e studentëve që kanë rënë nga ky provim. Juve ju karakterizon pasioni për drejtësi. Mirëpo, Justicia është e verbër, prandaj kur kopjoni ajo nuk ju sheh. Marre është me tnxon e jo… Jo koleg, harroje. Në atë dynja, gjykatësi suprem - Zoti do të të pyes: "A ke kopjuar?", ti thua "Jo.", por dora do të flasë për ty e do të përgjigjet ''po". Planeti Uran po renditet në yjësinë tuaj, lexoni me kujdes shenjat përreth jush.

Agronomi dhe Veterinari
—Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë



Të rrethuar me natyrën, gjendeni përballë një vendimi të rëndësishëm në jetën tuaj. Shihni mundësinë që para marrjes së vendimit të flisni me dikë më të moshuar. Çajeni një Somborkë përgjysmë dhe mundohuni të shihni brenda saj figurat që tregojnë të ardhmen tuaj. Nga prerja përgjysmë e bretkosës shihni në zorrët e saj, dhe fytyra që do t'ju shfaqet e para drejtojuni për këshillë. Një ndryshim i madh po vjen.

Artisti
—Fakulteti i Arteve



Ti nuk je artist. Ti e studion artin. Kohëve të fundit të janë zhdukur muzat. Nëse jeni në vitin e parë, tash është koha të eksperimentoni me veshjet tuaja, me të ecurit dhe gjestet tuaja. "Bota s'po më kupton" është fraza që do ta përdorni vazhdimisht. Ah! Oh! Sa botë e padrejtë kjo.
Kujdes! Përpjekja për arratisje nga komplekset aktuale, mund t'ju çojë në komplekse të tjera dhe përfundoni duke bërë të ashtuquajtur ''art abstrakt". Në dashuri do të ndjeheni i pafat, por Saturni shumë shpejt do të jetë në anën tuaj dhe ju do të keni sukses. Provoni!

T	B	Q	X	I	Z	K	Z	G	M	T	U	R	U	K	H	C	A	L	W
N	P	D	X	D	O	W	Y	C	F	S	K	K	L	Y	Z	X	B	N	A
Q	G	T	C	D	F	G	N	Q	V	J	I	Q	X	H	B	O	V	F	I
H	I	W	D	R	V	H	F	A	E	M	N	U	Q	D	S	M	U	D	I
M	N	T	S	R	T	U	I	P	E	Q	C	L	H	D	A	W	E	S	H
W	P	B	E	A	T	Q	P	D	V	E	X	V	G	S	X	E	Y	A	Z
F	N	L	B	T	C	U	A	U	Q	X	Y	R	H	T	B	M	Q	N	Y
G	P	P	I	M	I	K	I	L	S	P	H	T	L	U	T	V	W	C	Q
D	N	Q	E	D	A	R	O	I	R	A	R	M	D	J	S	Q	J	R	S
R	M	I	P	D	X	Z	G	W	Z	U	N	M	O	Q	E	C	A	U	P
W	S	I	S	F	I	O	V	E	E	R	R	G	P	I	L	L	Y	M	K
M	L	E	G	H	L	C	M	S	T	I	D	J	A	N	D	B	Y	P	O
D	I	Y	M	W	F	B	I	H	B	N	E	K	P	C	X	R	C	S	Y
O	J	H	V	S	O	A	M	Z	G	E	I	V	H	Y	M	H	M	T	J
Z	L	A	H	J	W	G	O	V	V	N	S	F	Q	I	L	U	F	Z	G
I	H	B	S	G	W	O	I	Y	B	C	Y	W	V	B	T	S	E	N	I
M	Q	O	T	U	P	T	N	F	C	P	A	N	S	R	L	U	W	S	O
I	R	W	K	A	A	I	P	O	E	X	N	Y	X	W	H	X	V	Y	I
T	D	J	M	J	W	V	D	P	C	K	I	V	Y	H	O	O	C	E	X
I	O	R	O	H	A	W	V	W	C	S	U	W	Y	R	S	W	F	S	S
D	G	U	M	J	N	T	V	V	Q	G	L	H	N	W	H	I	I	P	D
E	B	I	V	R	D	J	V	C	L	C	G	X	V	O	G	H	Z	C	J
R	B	I	R	W	B	M	P	D	S	B	G	Q	T	L	U	F	J	B	E
K	T	L	A	V	B	J	Y	L	Y	S	O	S	Q	V	Q	W	Y	J	I
A	Y	D	A	C	T	B	V	W	V	Y	P	R	N	U	L	D	M	R	R
A	R	U	T	A	I	J	G	A	L	P	G	D	G	V	O	B	D	R	O
V	G	Y	S	C	R	N	O	T	A	S	F	O	S	H	J	W	G	I	S
W	Z	U	W	I	I	B	C	B	H	F	E	L	T	A	A	A	A	D	E
E	Y	B	X	O	N	I	L	K	U	P	J	G	D	E	I	W	S	Z	F
Q	V	S	F	Q	A	J	Y	R	E	G	M	V	F	Z	M	R	H	C	O
Z	Y	Q	M	K	W	R	E	F	E	R	E	N	T	J	A	Q	G	U	R
C	X	E	P	L	R	U	X	Y	U	O	Y	K	L	T	P	A	H	S	P
X	Y	U	B	L	K	P	P	D	P	M	T	M	M	Q	D	I	F	U	A

TETËKAHORJA

Si student n'fakulltet duhesh me u marrë me gjëra serioze, andaj mos humb kohë, gjej fjalët në vijim në tetëkahore.

1. INTEGRITETI
2. AKADEMIKU
3. MASHTRUESI
4. PROFESORI
5. NGACMUESI
6. PLAGJIATURA
7. NOTA
8. SEMS
9. REFERENTJA
10. AKREDITIMI

USHTRIME ARITMETIKE



Bexhi, Mili dhe të tjerët po lahen në kënetën elektorale.

1. Sa shota janë në knetë? _____

2. Numëro edhe njëherë. Sa shota janë pas rinumrimit? _____

3. Sa herë duhet duhet t'i rinumrosh, që të të dalin 20 shota? _____

Skandali s'ka të ndalur

Hulumtuesit e ORCA-s nuk kanë mundur t'i rezitojnë tundimeve të fushatës elektorale. Përgjatë hulumtimit të listave për deputet, për të gjetur se cilët profesorë do e provojnë fatin në këto zgjedhje, ata kanë hasur në vështirësi aparenciale identifikuese.

Në listën e kandidatëve për deputetë nga AAK-PSD, ka figuru emri i Drita Krasniqit, një zonjë e nderuar nga Peja e cila si u kon tu nejt ma s'miri, veç kur e ka pa veten profesoreshë në Universitetin e Prizrenit siç është zakon në Kosovë "pa kUnkuru hiç".

T'i kthehemi realitetit, znj. Drita ka reagu menjëherë pasi e ka pa emrin e saj në atë listë dhe hulumtuesit e ORCA-s pas disa konflikteve verbale ndërmjet vete e kanë pranuar fajin. Në mesin tonë ka pasur asi (do do s'po përmenim emna, e dinë ata vet kush janë) që kanë insistu që nuk kemi gabu, në stilin e Dardan Molliqajt (ish deputet dhe së shpejti ish figurë publike) "o ngonum se jam i mirë n'kët punë".

Ne i kemi kërkuar falje të dy zonjave për shkak të lëshimit të paqëllimshëm, rrjedhimisht keqinformimin e publikut të gjerë për çështje me interes publik. Vërtetë ka qenë e vështirë me detektu, kështu që po iu japim edhe juve shansin me gjyku përmes fotove.



Drita Krasniqi
—kandidatja



Drita Krasniqi
— profesoresha

E tash seriozisht, kërkim falja e plotë:

KËRKIM FALJE PUBLIKE për znj. Drita Krasniqi, kandidate e AAK-së për deputete të Kosovës

Prishtinë, 02 tetor, 2019

ORCA i kërkon falje zonjës Drita Krasniqi, kandidate për deputete nga radhët e AAK-së për Kuvendin e Kosovës.

Kërkim falja bëhet për shkak të lëshimit të paqëllimshëm të bërë sot ku ORCA ka paraqitur publikisht emrat e profesorëve dhe asistentëve që janë edhe pjesë e listave të partive si kandidatë për deputetë.

ORCA ka paraqitur gabimisht duke keqinformuar publikun se zonja Drita Krasniqi kandidate për deputete e AAK-së është edhe profesoreshë në një nga universitetet publike.

Ky lëshim ka ndodhur për shkak se në Universitetin e Prizrenit ekziston një person me emër të njejtë dhe që ngjason jashtëzakonisht shumë me zonjën kandidate nga radhët e AAK-së.

ORCA dëshiron t'i sigurojë të dy zonjat në fjalë se lëshimi është absolutisht i paqëllimshëm dhe se kërkim falja jonë është e siqnertë.

Lusim mediet që kanë publikuar lajmin për aksionin e ORCA-s, ta publikojnë edhe këtë kërkim falje, ashtuqë askush të mos penalizohet për shkak të këtij gabimi.

Bashkë me këtë komunikatë ne po japim edhe dy fotografi të të dy zonjave ashtuqë edhe publiku të shohë se lëshimi ynë është i paqëllimshëm.

SHPALLJE

Boll u ankove, APLIKO!



Saranda Sylejmani
mendimtare

Na është bo praktikë me u anku kafeve dhe krejt mllefin e ditës me shfry me njoni tjetrin. Dikush propozon; "Shko te psikologu edhe fol me një profesionist për problemet e tuja, mos më ngarko me çështje të tilla. S'kom kohë me u marrë më ty"! Uhhh…qysh kërset sherri në këtë rast. Çele gur gojën, 2-sh për jetë, block-delete në facebook. Tash, s'ki pare me shku te psikologu se shtrejtë, në anën tjetër profesorët po ta bojnë të padrejtë, je emocionalisht i dërmum, plus s'ki hesap me ja tesh shoqërisë me ankesat tua t'përditshme se i hup përjetë. Kiamet, gjendje tejet e randë psiqike.

Në këtë rast pyetja parashtrohet "Qysh m'i adresu problemet në Universitetin që ta pamundëson me studiu si inson, si dhe qysh me përmirësu gjendjen aktuale në Universitet"?

Atëherë, p'e vërejmë që shkopi magjik s'po krynë punë, besa as belbzimet që cënojnë mirëqenien e indeve nervore të shokëve/shoqeve, por sipas të gjitha gjasave duhet me bo zemrën guri, me i fut muskujt në funksion (kryesisht trurin).

Me i ndjekë udhëzimet e ORCA-s ish shumë lehtë, e gjitha që duhet është me plotësu një aplikacion të thjeshtë, në mënyrë që me fitu një grant. Përmes këtij granti,i mandej të gjithë studentat që jonë të irritum me sistemin në Universitet, kanë mundësi me u mobilizu dhe me luftu të keqen. Projekti QAINT, i financum prej Austrian Development Agency dhe MAShT, është pikërisht për studentat e acarum me gjendjen e mjerushme në Universitet. Është projekt që subvencionon organizatat studentore dhe grupet jo-formale (nga 1500 deri në 3000 euro) të cilët kanë ide kreative se qysh me i luftu parregullsitë në Universitetet Publike në Kosovë.

Kështu që s'ka me tesh në të thatë mo, po me i zgjidh problemet si bossa. Ja sheh hajrin vet kësaj pune por edhe gjeneratat e ardhshme përfitojnë. Tash, këta të fundit pa beleshgji, po qysh kanë lonë fjalë pleqtë; "Kur ta don ta don".

Tre hapa drejt "suksesit" :

☞ Hyn në web faqen orca-ks.org

☞ Shiko: Thirrje për aplikim për grante për organizata studentore dhe grupe joformale

☞ Apliko

Redon Berisha shpallë të pavlefshëm vullnetin për të mësuar në semestrin e parë të vitit akademik 2019/2020

Anisa Zejnullahu ofron bajtjen e gajleve për të gjithë ata që kanë nevojë. Të interesuarit le të shkruajnë tek emaili anisazej_2@gmail.com, pa gajle!

Rinesa Latifi paralajmëron se do të mungojë gjatë javës kur luan futboll Kosova. Arsyetimi do të jetë për shkaqe shëndetësore.

Blerim Zejnullahu deklaron se i bie pishman regjistrimit në Fakultetin Filozofik, dega Filozofi, pasi që nuk doli të ishte ashtu si e ka pritur. Blerimi publikisht e pranon se është dashur t'i dëgjojë prindërit, të cilët qysh në moshë të njomë insistonin që të bëhet doktor.

Arton Gashi shpallë të pavlefshme ID kartelen e Universitetit për shkak se nuk po i pëlqen vetja qysh ka dalë në fotografi

A mos e ka pa dikush ni laps qitu dikun?

Agon Ibrahimi njofton të gjithë studentët e vitit të parë që po panikojnë se nuk po kuptojnë asgjë se nuk kanë pse të shqetësohen, pasi që as ai në vitin e dytë në nivelin Master, ende nuk po kupton asgjë.

Vijojmë ligjerata në vend tënd tel. 049 4915376

Shes skriptat e vitit të dytë të Fakultetit të Edukimit për djegie gjatë sezonës dimrore. Skriptat në posedim numërojnë gjithsejt 768 faqe, mjaftueshëm për këtë dimer. Tel: 044 5842499

Shes zhabën (bretoksën) për studentët e mjekësisë. Zhaba është pak e përdorur por në gjendje kryesisht të rregullt. Nuk i punon vetëm njëra këmbë e pasme. Malli i përdorur nuk kthehet. Tel 045 6821158

Ofroj dhomën për pushim gjatë kohës sa jam në ligjerata. Çmimi 5 euro ose me kompenzim larjen e të gjitha teshave apo gatim. Tel. 049 1783360

Ofroj konsulencë në aftësitë e kopjimit në provime. Email copyconsultant@hotmail.com

Ofroj shënimet e mbajtura gjatë ligjeratave në të gjitha lëndët të deparamentit të Shkencave Politike, Fakulteti Filozofik, niveli Bachelor. Shkrimi shumë i lexueshëm dhe i fotokopjueshëm. Gjithashtu edhe mund t'i dërgoj me email por kushton ekstra. Tel: 045 5914556.

Ofroj përkrahje morale. Tel: 044 9982042

Ofroj nejtjen gati për gjëra me rëndësi si përkujtimi i afateve të provimit, gjetjen e pyetjeve potenciale të provimeve, lajmërimit kur mungon ndonjë profesor, vëzhgimin e rezultateve etj. Tel: 049 8771609.


BLIKA E KOSOVËS
TI I PRISHTINËS
SAN PRISHTINA"
NË PRISHTINË
AGON IBRA
1990 në Prizren.
10 maj 2014 në:
EKONOMIKACION
titullin:
ELEKTRIKE
Kualifikimeve: 6
ECTS
35 maj 2014